

VENDIM

Nr.177, datë 31.3.2005

PËR NORMAT E LEJUARA TË SHKARKIMEVE TË LENGËTA DHE KRITERET E ZONIMIT TË MJEDISEVE UJORE PRITËSE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 14, pika 2, e 16 të ligjit nr.9115, datë 24.7.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, të Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit dhe të Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim synon të parandalojë, të zvogëlojë dhe të shmangë ndotjen e mjediseve ujore pritëse nga substancat e rrezikshme, që shkarkohen në to përmes ujërave të ndotura, duke përcaktuar vlerat kufi për përbërësit e lejuar, sipas shtojcave, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
2. Në kuptim të këtij vendimi, substancat e rrezikshme në përbërje të shkarkimeve të lëngëta, grupohen në listat I dhe II të shtojcës nr.1, që i bashkëlidhet vendimit në bazë të karakteristikave të tyre, që lidhen me toksicitetin, qëndrueshmërinë dhe bioakumulimin.
3. Për shkarkimet e lëngëta në ujërat ndërkufitare, që rregullohen nga marrëveshjet ndërkombëtare për mjedisin, ku Republika e Shqipërisë është palë, zbatohen vlerat kufi më të larta, që rezultojnë nga krahasimi i kërkesave të këtyre marrëveshjeve me ato që parashikon ky vendim.
4. Ndikimet që shkaktojnë shkarkimet e ujërave të ndotura në ujërat nëntokësore nuk janë objekti i këtij vendimi.
5. Zbatimi i kërkesave të këtij vendimi nuk sjell rritje të ndotjes së tokës, të ajrit apo të mjediseve ujore pritëse, që nuk janë objekt i tij.
6. Ministria e Mjedisit organizon, drejton dhe mbikëqyr monitorimin e ujërave të ndotura për përmbajtjen e substancave të rrezikshme, si dhe monitorimin e cilësisë së mjediseve ujore pritëse, të prekura nga shkarkimet e ujërave të ndotura, në bazë të programit kombëtar të monitorimit të mjedisit.
7. Këshillat e baseneve ujëmbledhëse, në bashkëpunim me agjencitë rajonale të mjedisit, çdo dy vjet, përgatisin dhe publikojnë programet për parandalimin dhe shmangien e ndotjes së mjediseve ujore pritëse nën juridiksionin e tyre, nga shkarkimet e lëngëta. Në këto programe përfshihen:
 - a) identifikimi i shkarkimeve të lëngëta dhe i mjediseve ujore pritëse, që ndoten;
 - b) masat dhe teknikat më të mira të mundshme për zvogëlimin e ndotjes;
 - c) propozimet për zëvendësimin ose riciklimin e substancave të rrezikshme nga veprimtaritë industriale përkatëse;
 - ç) përcaktimi i personave përgjegjës për zbatimin e kërkesave të programit;
 - d) koha e zbatimit të programit dhe monitorimi i procesit zbatues të tij.

KREU II

NORMAT E LEJUARA TË SUBSTANCAVE TË RREZIKSHME DHE PARAMETRAT E LEJUARA NË UJËRAT E NDOTURA, QË SHKARKOHEN NGA VEPRIMTARITË INDUSTRIALE

1. Normat e lejuara për substancat e rrezikshme, të lejuara, në ujërat e ndotura nga veprimtaritë industriale janë sipas shtojcës nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
Substancat e rrezikshme, që nuk figurojnë në shtojcën nr.2, nuk lejohet të shkarkohen në ujërat e ndotura nga veprimtaritë industriale.
2. Normat e lejuara për shkarkimet e lëngëta të sektorëve të industrisë janë sipas shtojcës nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Në veprimtaritë industriale ekzistuese të zbatohen normat e lejuara, sipas përcaktimeve të këtij kreu, brenda pesë vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Në vitin e parë të këtij afati subjektet, që ushtrojnë veprimtari industriale, duhet të paraqesin në këshillin e baseneve ujëmbledhëse përkatëse programin e masave, që do të marrin për zbatimin e normave të këtij vendimi. Pajisja e tyre me impiante për trajtimin e ujërave të ndotura, që shkarkojnë, është kërkesë e detyrueshme e programit dhe zbatohet brenda periudhës 5 -vjeçare.
4. Në veprimtaritë e reja industriale dhe në rikonstruksionet apo zgjerimet e veprimtarive ekzistuese të zbatohen normat e lejuara, sipas përcaktimeve të këtij kreu, që nga dita e fillimit të veprimtarisë. Këto subjekte, të cilat ushtrojnë veprimtari industriale, nuk pajisen me leje mjedisore, nëse nuk kanë ndërtuar impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura që shkarkojnë.
5. Kur, për arsye teknike, është e pamundur të zbatohen normat e lejuara sipas pikës 1 të këtij kreu, subjektet që ushtrojnë veprimtari industriale, njoftojnë me shkrim Ministrinë e Mjedisit, duke argumentuar teknikisht pamundësinë e zbatimit të këtyre normave. Në këtë rast, ministri i Mjedisit urdhëron monitorimin e mjedisëve ujorë pritëse dhe, nëse ato rezultojnë të padëmtuara nga shkarkimet e ujërave të ndotura, përcakton norma të lejuara përkohësisht, më pak rigoroze se ato të përcaktuara në këtë vendim. Normat e përkohshme, të autorizuar nga Ministri i Mjedisit, zbatohen deri në dy vjet. Gjatë kësaj periudhe subjekti merr masa për zbatimin e normave të lejuara për substancat e rrezikshme të lejuara, që shkarkohen me ujërat e ndotura të krijuara nga veprimtaria e tij.
6. Zbatimi i normave të lejuara sipas pikave 1 e 2 të këtij kreu kontrollohet:
 - a) në vendin ku veprimtaria industriale shkarkon ujërat e ndotura;
 - b) në një vend të përcaktuar, që përjashton mundësinë e përzierjes dhe hollimin me ujëra të tjera, të ndotura;
 - c) në një vend të përcaktuar, ku grumbullohen të gjitha ujërat e ndotura, që përmbajnë substanca të rrezikshme;
 - ç) në një vend të përcaktuar, ku grumbullohen të gjitha ujërat e ndotura të sektorit, për normat e përcaktuara në shtojcën nr.3;
 - d) në vendin ku ujërat e ndotura shkarkohen nga impianti i trajtimit të tyre, i instaluar për këtë qëllim.

KREU III

NORMAT E LEJUARA PËR SHKARKIMET E LËNGËTA URBANE

1. Shkarkimet e lëngëta urbane i nënshtrohen trajtimit mjedisor paraprak nëpërmjet sistemit të kanalizimeve, të ndara nga shkarkimet e tjera të lëngëta.
2. Ujërat urbane aglomerate, të zonave urbane intensive, pajisen me sisteme kolektorësh, sipas kriterëve të përcaktuara në shkronjën “A” të shtojcës nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Shkarkimet e lëngëta urbane në zonat e ndjeshme i nënshtrohen një trajtimi të veçantë, i cili përveç trajtimit parësor e dytesor, kërkon edhe trajtimin purifikues përkatës.
4. Shkarkimet e lëngëta urbane në zonat më pak të ndjeshme i nënshtrohen trajtimit parësor, me kusht që të mos ketë rritje të ndikimeve negative në mjedisin pritës.
5. Shkarkimet e ujërave të ndotura urbane, në zonat malore mbi 1 500 m mbi nivelin e detit, i nënshtrohen një trajtimi më pak rigoroz se sa ai i përcaktuar në pikën 1, të këtij kreu, me kusht që të mos ketë rritje të ndikimeve negative në mjedisin pritës.
6. Shkarkimet nga impiantet e trajtimit të ujërave urbane të trajtuara në pikat 3, 4 e 5 të këtij kreu, duhet të bëhen në përputhje me kërkesat e shkronjës "B" të shtojcës nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas tabelave respektive.
7. Ngarkesa e shprehur në njëvlerës për popullsinë llogaritet në bazë të ngarkesës mesatare maksimale javore, që hyn në impiantin e trajtimit gjatë një viti, duke përfshirë gjendjet e jashtëzakonshme, si rreshjet e dendura.
8. Për shkarkimet e lëngëta urbane zbatohen kërkesat e këtij vendimi, brenda 8 vjetëve nga hyrja në fuqi e tij.

KREU IV

KRITERET PËR ZONIMIN E MJEDISEVE UJORE PRITËSE

1. Kriteret për zonimin e mjediseve ujore pritëse, më të ndjeshme dhe më pak të ndjeshme, përcaktohen në shtojcën nr.5, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Listat e zonave të ndjeshme dhe të zonave më pak të ndjeshme rishikohen çdo 4 vjet. Për zonat e ndjeshme dhe për zonat më pak të ndjeshme, të identifikuar si të tilla pas rishikimit të listave, kërkesat e këtij vendimi zbatohen brenda një viti nga shpallja e tyre.
3. Kur ujërat e ndotura aglomerat, të zonave urbane intensive, me ngarkesë hyrëse në sistemin kolektor më shumë se 10 000 pe, shkarkohen në zona të ndjeshme, i nënshtrohen trajtimit të veçantë, të përcaktuar në pikën 3 të kreut III të këtij vendimi.
4. Shkarkimet nga impiantet e trajtimit të ujërave urbane në zonat e ndjeshme duhet të jenë në përputhje me kërkesat e paraqitura në tabelën 2, shkronja "B" të shtojcës nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
5. Kërkesat e pikave 3 e 4 të këtij kreu nuk zbatohen në zonat e ndjeshme, ku përqindja minimale e zvogëlimit të ngarkesës së përgjithshme, që hyn në të gjitha impiantet e trajtimit të ujërave urbane, është të paktën më e ulët se 75 për qind për fosforin dhe azotin total.
6. Shkarkimet e lëngëta urbane aglomerat, me ngarkesë hyrëse në sistemin kolektor nga 10000 pe-150 000 pe, përpara shkarkimit në ujërat bregdetare, dhe aglomeratet me ngarkesë nga 2000 pe-10 000 pe, përpara shkarkimit në estuare, të cilat u takojnë zonave të pandjeshme, mund të jenë subjekt i një trajtimi më pak rigoroz, vetëm nëse sigurohet se:
 - a) shkarkime të tilla i janë nënshtrohur, paraprakisht, trajtimit parësor;
 - b) studime të plota vërtetojnë se shkarkime të tilla nuk ndikojnë negativisht në mjedis.
7. Shkarkimet e lëngëta urbane nga sistemet kolektore janë subjekt i një trajtimi të veçantë në këto raste:
 - a) për shkarkimet në ujërat e ëmbla dhe estuare nga aglomerate me më pak se 2000 pe;
 - b) për shkarkimet në ujërat bregdetare nga aglomerate me më pak se 10 000 pe.
8. Derdhja e llumrave në mjediset ujore pritëse nga tubacionet e ndryshme, nga kanalizimet, nga sistemet kolektore, nga impiantet e trajtimit, nga anijet dhe nga çdo mjet apo mënyrë tjetër është e ndaluar.
9. Asgjësimi, djegia dhe çdo trajtim tjetër i llumrave nga impiantet e trajtimit të shkarkimeve të lëngëta urbane bëhen në përputhje me ligjin nr.9010, datë 13.2.2003 "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta".

KREU V

MONITORIMI

1. Procedurat e monitorimit për zbatimin e normave të lejuara, të paraqitura në shtojcën nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfshijnë:
 - a) përllogaritjen e fluksit të përgjithshëm të shkarkuar të ujërave të ndotura, për një periudhë 24-orëshe;
 - b) marrjen e një mostre të ujërave të ndotura gjatë një periudhe 24-orëshe dhe matjen e përqendrimit të substancave të rrezikshme në të;
 - c) përcaktimin, ku është e mundur, të sasisë së substancave të rrezikshme të prodhuara, të trajtuara apo të përdorura, duke përdorur metodat e përllogaritjes.
 2. Sasia e substancave të rrezikshme, të shkarkuara në ujërat e ndotura gjatë një muaji, llogaritet si shumë e shkarkimeve të çdo dite, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij kreu.
 3. Metodatat e referencës për përcaktimin e pranisë së substancave të rrezikshme në ujërat e ndotura jepen në shtojcën nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Gjithashtu, mund të përdoren edhe metoda të tjera, nëse ato sigurojnë rezultate minimalisht të njëjta me ato të metodave të referencës.
 4. Procedurat e monitorimit për zbatimin e normave të lejuara, të paraqitura në shtojcën nr.4, përfshijnë mbledhjen e mostrave, sipas fluksit të shkarkimeve ose një herë në 24 orë, në të njëjtën pikë të paracaktuar në dalje të impiantit të trajtimit të shkarkimeve të lëngëta urbane.
 5. Numri minimal vjetor i mostrave, sipas pikës 4 të këtij kreu, përcaktohet në shkronjën "C" të shtojcës nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 6. Metodatat e referencës, të përdorura për përcaktimin e normave të ujërave të ndotura urbane, jepen në tabelat 1 e 2, të shtojcës nr.4.
 7. Ujërat e ndotura urbane plotësojnë kërkesat për normat e lejuara sipas këtij vendimi, vetëm nëse për çdo normë të marrë veçmas, mostrat e analizuar janë në përputhje me vlerat përkatëse, si më poshtë vijon:
 - a) Kur normat e tabelës 1, të shtojcës nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi, janë të shprehura në përqendrim, maksimumi i mostrave që lejohet të mos jenë në përputhje me kërkesat jepet në tabelën 3, të po kësaj shtojce;
 - b) Kur normat e tabelës 1 të shtojcës nr.4 janë të shprehura në përqindje, mostrat që lejohen të mos jenë në përputhje me kërkesat, të marra në kushte normale pune, nuk duhet të ndryshojnë me më shumë se 100 për qind, për pezullitë totale. Ndryshimet janë të pranueshme deri në 150 për qind;
 - c) Për normat e përcaktuara në tabelën 2 të shtojcës nr.4, mesatarja vjetore e mostrave, për çdo normë, duhet të jetë në përputhje me vlerat përkatëse të normave të lejuara.
 8. Vlerat ekstreme nuk merren parasysh në llogaritjen sipas pikës 7 të këtij kreu, nëse ato janë rezultat i mostrave të marra në gjendje të jashtëzakonshme, si rreshje të dendura.
 9. Këshillat e baseneve ujëmbledhese, çdo dy vjet, të publikojnë raportet për gjendjen e ujërave të baseneve nën juridiksionin e tyre, për shkarkimet e lëngëta dhe largimin e llumrave nga impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura.
 10. Ngarkohen Ministri i Mjedisit, Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit dhe Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

SHTOJCA NR.1

Lista I e familjeve dhe grupeve të substancave

Lista I përmban disa substanca të veçanta të cilat takohen në familjet dhe grupet e mëposhtme, seleksionuar me kujdes në bazë të toksicitetit të tyre, qëndrueshmërisë dhe bioakumulimit, me përjashtim të atyre, të cilat janë biologjikisht të padëmshme ose të cilat janë konvertuar në substanca të cilat janë biologjikisht të padëmshme:

1. përbërësit organohalogjen dhe substancat të cilat mund të formojnë përbërës ose komponentë të tillë në mjedisin ujor;
2. përbërësit organofosforues;
3. përbërësit organikë;
4. substancat për të cilat është provuar që ato zotërojnë veti kancerogjene në mjedise ujore, kur disa substanca të listës II janë kancerogjene, ato gjithashtu janë përfshirë në këtë kategori;
5. mërkuri dhe komponentët e tij;
6. kadmiumi dhe komponentët e tij;
7. vajrat mineral persistente dhe hidrokarburet me origjinë naftore;
8. substancat sintetike persistente të cilat mund të notojnë, qëndrojnë pezull ose të fundosura dhe të cilat interferojnë në mjedise ujore.

Lista e II e familjeve dhe grupeve të substancave

Lista II përmban:

A. Substancat që i përkasin familjeve dhe grupeve të substancave në listën I për të cilat vlerat e lejuara nuk janë përcaktuar me këtë vendim.

B. Disa substanca të vecanta dhe kategori të substancave që bëjnë pjesë në familjet dhe grupin e substancave të listuara më poshtë, të cilat kanë efekte të dëmshme në mjedise ujore, edhe pse mund të jenë të kufizuara në një zonë të caktuar dhe të cilat varen nga karakteristikat dhe vendi mjedisit ujor në të cilin shkarkohen.

Familjet dhe grupet e substancave sipas pikës B

I. Metaloidet dhe metalet e mëposhtme dhe përbërësit e tyre:

- | | | | |
|----------|-------------|--------------|--------------|
| 1. Zink | 6. Selen | 11. Kallaj | 16. Vanadium |
| 2. Baker | 7. Arsenik | 12. Barium | 17. Kobalt |
| 3. Nikel | 8. Antimon | 13. Berilium | 18. Talium |
| 4. Krom | 9. Molibden | 14. Bor | 19. Telurium |
| 5. Plumb | 10. Titan | 13. Uranium | 20. Argjend |

II. Biocidet dhe derivatet e tyre që nuk janë listuar.

III. Substancat të cilat kanë një efekt të dëmshëm mbi shijen dhe/apo erën e produkteve për konsum njerëzor, të ardhura nga mjedisi ujor dhe përbërësit përgjegjës për lindjen e substancave të tilla në ujë.

IV. Përbërësit toksikë ose organikë të qëndrueshëm të silikonit dhe substancat të cilat mund të çojnë në lindjen e substancave të tilla në ujë, përjashtuar ato të cilat janë biologjikisht të padëmshme ose të cilat janë kthyer shpejt në ujë në substanca të padëmshme.

V. Përbërësit inorganikë të fosforit dhe fosfori elementar.

VI. Vajrat mineralë jo persistente dhe hidrokarburet me origjinë naftore.

VII. Cianidet dhe fluoret.

VIII. Substancat të cilat kanë një efekt të kundërt në balancën e oksigjenit, veçanërisht amoniaku, nitritet.

Shtojca Nr.5

Kriteret për identifikimin e zonave të ndjeshme dhe atyre më pak të ndjeshme

A. Zonat e ndjeshme

Një trup ujqor identifikohet si zonë e ndjeshme nëse i përket njërës prej grupeve të mëposhtme:

1. Liqeneve natyrore me ujë të ëmbël, ujërave të tjera të ëmbëla, estuareve dhe ujërave bregdetare të cilat janë eutrofike ose të cilat mund të kthehen në të ardhmen e afërt në të tillë, nëse nuk ndërmerren masa për mbrojtjen e tyre.

Trupat ujore të mëposhtëm duhet të merren në konsideratë në rastet kur elemente të veçantë ushqyes duhen verifikuar për të ulur nivelin e tyre përmes trajtimeve të mëtejshme:

a) liqenet dhe rrymat që arrijnë në liqene/rezervuare/gjire të mbyllura të cilat verifikohet të kenë një këmbim ujqor të dobët, ku mund të ndodhin akumulime: në këto zona, eliminimi i fosforit është i rëndësishëm për të ulur shkallën e eutrofikimit. Kur ka shkarkime aglomerate edhe eliminimi i azotit duhet konsideruar;

b) estuaret, gjiret dhe të tjera ujëra bregdetare të cilat kanë një këmbim ujqor të dobët, ose të cilat marrin sasi të mëdha ushqyesish: në këto zona, kur ka shkarkime aglomerate të mëdha eliminimi i fosforit dhe/ose azotit është i rëndësishëm për të ulur shkallën e eutrofikimit.

2. Ujërave të ëmbëla sipërfaqësore të destinuara për ujë të pijshëm në të cilat përqendrimi i nitrateve, si rezultat i mosmarrjes së masave mund të kalojë mbi normat e lejuara.

3. Zonave ku një trajtim i mëtejshëm është i nevojshëm me qëllim që të plotësohen vlerat e lejuara për kategoritë specifike të trupave ujore përbërës të këtyre zonave.

B. Zonat më pak të ndjeshme

Një trup ujqor detar ose një zonë mund të identifikohet si më pak e ndjeshme, nëse shkarkimet e ujërave të ndotura nuk afektojnë mjedisin përkatës në kuptim të kushteve specifike morfologjike, hidrologjike ose hidraulike.

Në identifikimin e zonave më pak të ndjeshme, risku që ngarkesa e shkarkuar mund të transferohet në një zonë të afërt ku mund të shkaktojë dëmtime të pariparueshme mjedisore duhet të merret gjithashtu në konsideratë. Prezenca e zonave të ndjeshme jashtë territorit të vendit duhet gjithashtu të bëhet e njohur për t'u pasur nën kujdes.

Trupat ujore të mëposhtme duhet të kihen parasysh në përcaktimin e zonave më pak të ndjeshme: gjiret e hapura, estuaret dhe ujërat bregdetare me këmbim të mirë ujqor dhe jo subjekt i eutrofikimit ose pakësimit të oksigjenit, ose të cilat ka pak të ngjarë të bëhen eutrofike ose të shkojnë drejt pakësimit të oksigjenit për shkak të shkarkimit në to të ujërave të ndotura urbane.